



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01- 8275/25
Kaçanik, 22.04.2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **IV (katërt)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 22 prill 2025 (e Martë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 13:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Arben Thaqi- OJQ. Në takim mori pjesë Jaser Jaha – Zëvendëskomandant i stacionit policor në komunën e Kaçanikut.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e IV-të (katërt) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2025, data 22 prill, me këtë :

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut;
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete,

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?

Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbali ?

Procesverbali i mbledhjes së III-të (tretë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2025, u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komiteti për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së III-të (tretë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2025, të datës 20.03.2025 / Lënda: 01Nr. 60/01-5907/25.

2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut;

z.Ekrem Livoreka: Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin:

z.Jaser Jaha: Gjendja e sigurisë në komunën tonë, gjatë periudhës tremujore deri më tani, mund të konsiderohet si e mirë. Gjatë kësaj periudhe, në Stacionin Policor janë raportuar gjithsej 36 raste.

Rasti më i rëndësishëm dhe më shqetësues për ne, për komunën tonë dhe në veçanti për Policinë në Kaçanik, është rasti i vrasjes së rreshterit Muhamed Lika. Lidhur me këtë rast, hetimet janë marrë nga niveli i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, përkatësisht Drejtoria për Krime të Organizuar, dhe ato janë duke i zhvilluar hetimet që nga dita e ngjarjes. Hetimet janë ende në vazhdim.

Siç jeni njoftuar edhe nga mediat, është ndërmarrë një veprim policor në Kaçanik, ku janë arrestuar disa persona. Rasti është duke u udhëhequr nga Drejtoria për Krime të Organizuar, e cila është përgjegjëse për këtë çështje. Për më shumë detaje nuk do të thellohem, pasi hetimet janë ende në zhvillim dhe janë në kompetencë të kësaj drejtorie. Nga ana jonë, mbetemi të angazhuar në ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike.

Jemi duke punuar me disa plane operative, ndër të cilat veçohet funksionimi i njësive sektoriale brenda stacionit policor, që është pjesë e programit "Policia në bashkësi", një strategji e Policisë së Kosovës. Kjo njësi është duke zbatuar planin e veprimit përkatës dhe është e angazhuar në mbajtjen e ligjëratave në shkollë, me tema që lidhen me gjendjen aktuale të sigurisë, si dhe dukuri negative, veçanërisht ato që prekin të rinjtë dhe nxënësit. Gjithashtu, jemi të përkushtuar në realizimin e planeve operative për sigurinë në trafik, si dhe për sigurinë e përgjithshme në komunë.

znj.Arta Avdiu: Desha të di, zëvendëskomandant, se ku keni mbetur me këtë çështje, pasi kamerat e sigurisë nuk janë funksionale tash e disa vite. Kush është përgjegjës për këtë situatë?

Kërkoj të na jepni një informacion të qartë, sepse komuna po e hedh fajin te ju, ndërsa ju te komuna. A mund të dihet realisht se kush mban përgjegjësi për këtë gjendje? Funksionalizimi i këtyre kamerave do të kishte ndihmuar në zbardhjen e shumë rasteve.

z.Jaser Jaha: Të gjithë e dimë që kamerat e sigurisë janë jashtëzakonisht të nevojshme për të qenë funksionale, sepse ato mund të ndihmojnë në parandalimin dhe zbardhjen e shumë rasteve, dhe ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e përgjithshme. Në qytetin e Kaçanikut janë të vendosura rreth 68 kamera, nëse nuk gaboj me numër, pasi kemi punuar për një kohë të gjatë me to.

znj.Arta Avdiu: A është e vërtetë se asnjë kamerë e sigurisë nuk është funksionale aktualisht në komunën tonë?

z.Jaser Jaha: Asnjë nga kamerat e sigurisë aktualisht nuk është funksionale. Bëhet fjalë për dy projekte të realizuara gjatë viteve 2017–2018, të cilat kanë qenë nën menaxhimin e kompanisë fituese të tenderit për një periudhë dyvjeçare. Ajo kompani ka qenë përgjegjëse për mirëmbajtjen e kamerave.

Me kalimin e kohës, kamerat kanë filluar të dëmtohen si pasojë e kushteve atmosferike dhe në disa raste edhe për shkak të punimeve ndërtimore. Fatkeqësisht, asnjëherë nuk janë rikthyer në gjendjen e mëparshme funksionale.

Këtë çështje e kemi ngritur disa herë me zyrtarët e Kuvendit Komunal, kryesisht me drejtorin e Shërbimeve Publike, z. Ramadush Osmani, dhe na është thënë se nuk ka buxhet të ndarë për këtë qëllim. Kemi kërkuar zyrtarisht me shkrim dhe gjithashtu kemi përcjellë kërkesa edhe verbalisht disa herë.

Në nivel të Policisë së Kosovës, nuk kemi buxhet të ndarë për mirëmbajtjen e kamerave. Të gjitha stacionet e policisë në Kosovë kanë marrëveshje interne me komunat për mirëmbajtjen e tyre. Sipas informatave që kemi, ndonëse jo zyrtare, edhe komunat si Ferizaj, Shtime, Hani i Elezit dhe Shtërpca kanë marrë përsipër mirëmbajtjen ndërsa tek ne kjo çështje ka mbetur pa zgjidhje.

Në një rast, përmes iniciativës sonë, kemi arritur të riparojmë një pjesë të kamerave me ndihmën e një kompanie lokale, por më pas ato janë dëmtuar sërish dhe tani nuk funksionojnë.

Sipas një urdhërese nga Shtabi i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kemi qenë të njoftuar se monitorimi i kamerave duhet të bëhet vetëm nga Policia e Kosovës. Para disa vitesh (nuk e kujtoj saktë vitin), i kemi dërguar një shkresë Kryetarit të Komunës, dhe pas asaj kohe, një pjesë e kamerave ka qenë e monitoruar edhe nga komuna. Mirëpo, që nga ajo periudhë, ky monitorim është ndërprerë.

Së fundmi, megjithëse kam qenë me pushim vjetor, jam njoftuar se kjo çështje është diskutuar më seriozisht, sidomos pas rastit të vrasjes së ndodhur në qytetin tonë.

Një zyrtar komunal na ka informuar se riparimi i kamerave është planifikuar dhe pritet të realizohet shumë shpejt.

Përveç kësaj, kemi përgatitur edhe një projekt për vendosjen e kamerave shtesë në hyrje-daljet e fshatrave. Ky projekt është dorëzuar në komunë, mirëpo jemi informuar se ka kosto të lartë buxhetore dhe pritet të zgjasë më shumë kohë.

Në anën tjetër, për rifunksionalizimin e kamerave ekzistuese, jemi informuar se pritet të realizohet së shpejti. Ne si stacion policor, në kuadër të regjionit të Ferizajt, kemi staf IT, por nuk kemi buxhet për këtë çështje.

Nëse komuna do ta përmbushë këtë kërkesë apo jo, mbetet përgjegjësi e saj. Sidoqoftë, kjo është një çështje shumë e rëndësishme dhe e ndjeshme, sepse nëse këto kamera do të ishin funksionale, do të na ndihmonin shumë në zbardhjen e rasteve penale.

znj.Arta Avdiu: Zëvendëskomandant, po ndërlidhem me çështjen që përmendët për kompaninë që ka qenë përgjegjëse për mirëmbajtjen e kamerave të sigurisë. A keni bërë ndonjë ankesë zyrtare ndaj asaj kompanie për moskryerjen e detyrimeve të saj? A i ka skaduar afati i kontratës?

z.Jaser Jaha: Po, afati i kontratës i ka skaduar. Kompania ka pasur përgjegjësi për dy vite mirëmbajtjeje dhe pas përfundimit të afatit, nuk ka pasur më kontratë aktive.

znj.Arta Avdiu: Kush është përgjegjës për hapjen e tenderit për sigurimin dhe mirëmbajtjen e kamerave komuna apo policia?

z.Jaser Jaha: Në parim, ne si polici jemi përgjegjës, sepse kamerat janë asete tona dhe ne i monitorojmë. Mirëpo, na është thënë nga niveli qendror (Policia e Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme) se nuk ka buxhet të ndarë për këtë qëllim. Për këtë arsye, në shumicën e komunave, kjo çështje është rregulluar përmes marrëveshjeve të brendshme ndërmjet komandantëve të stacioneve policore dhe kryetarëve të komunave. Fatkeqësisht, në komunën tonë një marrëveshje e tillë nuk është realizuar, dhe për rrjedhojë mirëmbajtja ka mbetur pezull.

z.Ekrem Livoreka: Kryetari i Komunës po e hedh fajin tek ju (Policia), duke thënë se nuk mund të ndajë asnjë euro nga buxheti për këtë çështje, me arsyetimin se nuk ka kompetencë për të ndërhyrë në sistemin e kamerave të sigurisë për shkak të procedurave të prokurimit publik. Realisht, kompetencat për menaxhimin dhe funksionalizimin e kamerave duket se i ka Policia. Cila është e vërteta?

z.Jaser Jaha: Ashtu na është thënë gjithmonë nga Komuna se nuk kanë kompetencë dhe as buxhet të ndarë për këtë çështje, për shkak të kufizimeve ligjore dhe procedurave të prokurimit. Kjo është arsyeja që na është dhënë në vazhdimësi.

z. Arben Thaçi: Nuk është e kushtueshme një tender sa është e vlefshme jeta e një njeriu. Rasti i fundit, vrasja e rreshterit, është një ngjarje shumë shqetësuese, që ka prekur të gjithë komunitetin tonë. Unë nuk besoj që kostoja e një tenderi mund të krahasohet me humbjen e një jete njerëzore. Kjo është arsyeja pse duhet të ketë bashkëpunim të drejtpërdrejtë dhe funksional mes Policisë dhe Komunës, në mënyrë që të mos kemi më raste të tilla tragjike. Besoj dhe shpresoj që tash e tutje kjo çështje do të trajtohet me seriozitet dhe do të zgjidhet sa më parë. Njëkohësisht, dua të pyes për bashkëpunimin tuaj me Gjykatat dhe Prokurorinë në lidhje me të arrestuarit e fundit, të cilët sipas njoftimeve janë pjesë e një grupi që është identifikuar si një organizatë e rinisë islame. A keni verifikuar nëse kjo organizatë është e regjistruar si OJQ, apo si ka funksionuar ajo? Sepse nëse nuk është e regjistruar dhe ka funksionuar ilegalisht, atëherë kemi të bëjmë me një akt të mundshëm terrorist dhe me një rrezik serioz për sigurinë publike. Gjithashtu, sipas disa njoftimeve, të njëjtit persona kanë qenë edhe sulmues të Gjykatës në raste të mëparshme. Kjo më çon të pyes: çfarë veprimesh ka ndërmarrë Gjykata në lidhje me ta? E di që Policia e ka përmbushur detyrën e identifikimit, i ka arrestuar dhe i ka dorëzuar atje ku duhet por vendimi final mbetet te Gjykata. Unë mendoj se mosmarrja e vendimeve të duhura nga ana e Gjykatave ka kontribuar drejtpërdrejt që ky grup të vazhdojë aktivitetet e tij dhe, në fund, të ndodhë edhe tragjedia që na ka tronditur të gjithëve. Nga informacionet që kemi, edhe në Han të Elezit ka pasur pjesëtarë të këtij grupi, që do të thotë se rreziku ka qenë i shpërndarë dhe real. Prandaj është me rëndësi që bashkëpunimi mes Policisë, Prokurorisë dhe Gjykatës të jetë shumë më i ngushtë dhe më efikas, sepse vetëm kështu mund të parandalohet ndonjë rast tjetër tragjik.

z.Jaser Jaha: Sa i përket bashkëpunimit me Gjykatat, mund të them se bashkëpunimi është i ngushtë dhe funksional. Policia dhe Gjykatat janë dy sektorë që patjetër duhet të kenë një bashkëpunim të ndërsjellë, ashtu si edhe me Prokurorinë, sepse pa një koordinim të mirë, efikasiteti në trajtimin e rasteve të sigurisë bie ndjeshëm.

Sa i përket organizës së quajtur "Rinia Islame", dhe nëse ajo është OJQ e regjistruar apo jo, duhet ta themi me sinqeritet se nuk kemi informacion të plotë në nivel lokal. Ne si stacion policor dërgojmë informata për çështje të caktuara që lidhen me sigurinë, por rasti në fjalë është në trajtim nga Njësi Kundër Terrorizmit në nivel qendror.

Vetëm ai njësit ka të gjitha detajet dhe mund të japë informacione të sakta dhe të verifikuara për këtë çështje që po diskutojmë. Për ne, mbetet shumë shqetësuese që edhe një person i vetëm të jetë pjesë e një organizate që merret me akte kriminale apo potencialisht terroriste dhe për këtë arsye, duhet të ketë reagim dhe luftë institucionale ndaj çdo forme të tillë rreziku. Për më shumë detaje është njësit përkatës kundër terrorizmit.

znj.Arta Avdiu: Sipas informatave të qarkulluara në rrjetet sociale ndonëse nuk mund të konfirmoj saktësinë e tyre thuhet se njëri nga të dyshuarit, konkretisht dorasi i rreshterit të ndjerë Muhamed Lika, ka qenë më herët i denoncuar për dhunim. Po ashtu, kam lexuar se në vitin 2022 ka pasur një urdhër arresti për këtë person. Ju, si Polici, a mund të na informoni nëse kjo është e vërtetë? Dhe nëse vërtet ka ekzistuar një urdhër arresti, pse nuk është arrestuar ky person gjatë gjithë kësaj kohe?

z.Jaser Jaha: Po, ka pasur një urdhër arresti, por jo që nga viti 2022. Urdhri ka ardhur në fund të vitit 2024, konkretisht në muajin dhjetor. Ai është kërkuar disa herë në vendbanimin e tij, mirëpo nuk është gjetur. Sipas informatave që kemi pranuar nga persona të afërt me të, është thënë se ndodhej jashtë shtetit në atë kohë.

z.Ekrem Livoreka: Në ditën kur ndodhi vrasja e rreshterit Muhamed Lika, përmes disa portaleve dhe ekspertëve të sigurisë, është publikuar emri i një personi jo me initiale, por emër dhe mbiemër i plotë pa ndonjë konfirmim nga Prokuroria, gjë që ka vënë në rrezik serioz jetën dhe sigurinë e familjes së tij, ndërkohë që më vonë doli që nuk ishte fare ai person, por dikush tjetër.

z.Jaser Jaha: Fatkeqësisht, ka raste kur para se të dalë një komunikatë zyrtare nga Policia ose Prokuroria, del ndonjë individ apo media me emër konkret, që shpeshherë rezulton të jetë i pasaktë. Edhe nëse personi i përmendur nuk është i rrezikuar drejtpërdrejt, etiketime të tilla janë shumë shqetësuese, pasi dëmtojnë emrin dhe reputacionin e tij. Mediat, për fat të keq, nuk po veprojnë me përgjegjësi në raste të tilla.

3.Të ndryshme:

z.Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 14:27.

Procesmbajtës
Mavije Murseli



Kryesues i Komitetit
Ekrem Livoreka

